REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

DREJTORIA E FINANCAVE

DATA/DATUM/DATE	31/08/2026
NR/BR.	03 Nr. 95/26
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës Ferizaj Komitetin për Politikë dhe Financa
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim - Vendim për miratimin e Projekt Buxhetit të Komunës së Ferizajt për vitin 2027

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Mbështetur në qarkoren buxhetore 2027/02, organizata jonë buxhetore, ka hartuar Projekt-Buxhetin e Komunës per vitin fiskal 2027, i cili përmban kufijtë përfundimtar buxhetor të të gjitha burimeve të financimit, përfshire grantet qeveritare si dhe planifikimin e të hyrave vetanake, për vitin fiskal 2027, si dhe vlerësimet buxhetore për vitin 2028 dhe 2029.

Me këtë propozim bëhet miratimi në parim i këtij dokumenti strategjik të projekt buxhetit per vitin fiskal 2027.

Të nderuar anëtarë të kuvendit, në vazhdim keni të bashkangjitur Projekt-Buxhetin e

Komunës së Ferizajt për vitin 2027 .

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

PROJEKTBUXHETI 2027-2029

FERIZAJ

PËRMBAJTJA

Misioni dhe qëllimi. 3
Përkufizimi i termeve 4
Përmbledhje 5
Procesi i hartimit të projekt buxhetit 2027-2029 6
Struktura e financimit buxhetor 7
Struktura buxhetore me burim financimi dhe krahasimi 2026/2027 8
Synimet e qeverisë lokale në kuadër të planifikimit buxhetor 9
Kufijtë e financimit 10
Burimet e financimit 10
Përcaktimi i prioriteteve 12
Ndikimi i buxhetit krahas problemeve të Komunës 12
Shpërndarja buxhetore në kategori ekonomike 13
Shpërndarja e buxhetit në programe buxhetore 18
Tabela I - Të hyrat dhe shpenzimet komunale 19
Tabela II - Plani Afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal. 20
Tabela III - Plani i ndarjeve buxhetore 21
Tabela IV - Plani Afatmesëm 2027-2029 për investime kapitale. 27
Tabela V - Financimi i projekteve sipas burimeve të financimit 34

Misioni dhe qëllimi

Deklarata e misionit : Komuna e Ferizajt është njësi themelore territoriale administrative e Republikës së Kosovës në të cilën qytetarët e saj realizojnë të drejtat e tyre në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e aplikuara. Në bazë të kësaj, Komuna është e obliguar dhe përgjegjëse për realizimin e kërkesave të qytetarëve në të gjitha fushat në mënyrë që të ndërtoj dhe ngris mirëqenien e tyre, duke ofruar shërbime efikase, si dhe investime në infrastrukturën e përgjithshme. Përmes Kuvendit si organ legjislativ, miraton një sërë vendimesh për rregullimin e infrastrukturës si të asaj ligjore (vendime, miratimit të rregulloreve, strategjive etj) ashtu edhe asaj ekonomike e sociale. Përmes Kryetarit të Komunës, përkujdeset për realizimin e të gjitha vendimeve nga të gjitha lëmitë, grumbullon taksat dhe ngarkesat administrative nga qytetarët për të financuar më pas projektet që janë në të mirën e përgjithshme.

Qëllimi i misionit: Rritja e efikasitetit, përgjegjshmërisë, transparencës, respektim i standardeve ligjore e procedurale në shërbimet administrative. Programi i qeverisjes lokale do të fokusohet në mënyrë të veçantë, që të ofroj qytetarëve shërbime administrative cilësore si dhe në avancimin e mëtejmë të përdorimit të teknologjisë informative, nëpërmjet procesit të digjitalizimit të të gjitha shërbimeve administrative, në të gjitha fushat. Administrata synon të siguroj të gjitha shërbimet administrative efikase përmes Kuvendit dhe Kryetarit të Komunës në funksion të mirëqenies së qytetarëve të Komunës sonë. Kryetari i Komunës menaxhon buxhetin e Komunës të miratuar nga Kuvendi i Komunës dhe ai i Republikës së Kosovës, në përputhje të plotë me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe të Ligjit mbi Financat Lokale, gjithashtu realizimin e interesave të qytetarëve përmes departamenteve përkatëse komunale.

PËRKUFIZIMI I TERMEVE

(përkufizimi i termeve që përdoren në këtë dokument)

Paga dhe Shtesa- Mjetet e parapara për pagesën e pagave të rregullta të punëtorëve që gjenden në listën e rregullt të pagave, pagesat për mëditjet e Anëtarëve të Kuvendit të Komunës, pagesat për mjekët të cilët realizojnë kujdestari në shëndetësi si dhe pagesat e ndryshme për stimulime dhe mëditjet e udhëtimeve zyrtare.

Mallra dhe Shërbime- Mjetet e parapara për blerje të ndryshme siç janë furnizimet me material zyre, furnizime me pajisje, furnizime me derivate etj. Kryerje të sherbimeve të ndryshme siç janë shërbimet kontraktuese, mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve si dhe shpenzime të cilët janë të nevojshme për realizimin e detyrave dhe obligimeve të drejtorive përkatëse komunale.

Komunali- Kategori ku janë të përfshira pozicionet e kategorisë ekonomike të shpenzimeve siç janë: shpenzimet e energjisë elektrike, shpenzimet e ujit, shpenzimet e mbeturinave, shpenzimet e telefonisë dhe shpenzimet tjera komunale publike.

Subvencionet dhe transferet- Kjo kategori ekonomike përfshinë shpenzimet e parapara për ndihmapër raste të ndryshme sociale, ndihma për familjet e Dëshmorëve, fëmijët bonjak, si dhe të tjerë, bursa për studentë, si dhe participimet në kulturë, rini dhe sport.

Investime kapitale- Kjo kategoritë ka të bëj me investimet e ndryshme kapitale në infrastrukturë si: rregullimi i rrugëve, sistemit të kanalizimit dhe ujësjellësit, ndërtimi i objekteve të ndryshme si shkollat, pastaj ndërtesave shëndetësore,parqeve etj.

Të Hyrat Vetanake- Ka të bëj me grumbullimin e të hyrave që janë të parapara me Udhëzime Administrative(UA) dhe Rregulloren Komunale mbi të hyrat vetanake. Këtu kemi të bëjmë me Tatimin në Pronë, taksat e biznesit, të hyrat nga shërbimet gjeodezike, shërbimet e urbanizmit, të hyrat nga dhënia e pronës komunale me qira si dhe të hyrat tjera administrative.

Granti Qeveritar- Ka të bëj me mjetet e ndara nga Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Financave nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK).

Shërbimet e kontraktuara;- Ka të bëj me disa kategori të shpenzimeve që realizohen me kontrata që nuk kanë të bëjnë me furnizime por janë kategori të shërbimeve të ndryshme.

Furnizimet e tjera;-Furnizimet të cilat nuk i takojnë furnizimeve që parashihen me pozicione ekonomike të rregullta. Si të tilla, ato paraqesin raste të veçanta.

UA – Udhëzim Administrativ
MFPT – Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
BKK – Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KK Ferizaj – Kuvendi i Komunës së Ferizajt
KPF – Komiteti për Politikë dhe Financa
PIP – Programi i Investimeve Publike
TI- Teknologjia Informative

PËRMBLEDHJE

Buxheti i vitit 2027 është hartuar në harmoni me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2027-2029, Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Ferizajt 2027-2029 dhe procedurat e përcaktuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes Qarkoreve Buxhetore 2027/01 dhe 2027/02. KAB-i ka shërbyer si bazë strategjike për ndërlidhjen e prioriteteve zhvillimore me shpërndarjen e burimeve publike. Projektbuxheti për vitin 2027 arrin në 56,102,329.00 €, ose 3,033,835.00 € më shumë se buxheti i vitit 2026, që paraqet rritje prej 5.72%. Planifikimi 2027-2029 synon përdorim efikas të mjeteve, forcim të shërbimeve publike dhe realizim të investimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve.

Për periudhën 2027-2029, vizioni zhvillimor i Komunës së Ferizajt është i orientuar drejt një Ferizaj modern, të digjitalizuar, të gjelbër, funksional dhe të bashkë-qeverisur me qytetarët. Komuna synon modernizimin e shërbimeve, forcimin e ekonomisë lokale, përmirësimin e arsimit dhe shëndetësisë, zhvillimin e qëndrueshëm urban e rural, si dhe partneritete me sektorin privat, donatorët dhe diasporën për të rritur kapacitetin investiv dhe punësimin.

Procesi i hartimit të Projekt-Buxhetit 2027-2029

Mbështetur në rëndësinë jetike që ka buxheti si ligj për të materializuar dhe ngritur mirëqenien e qytetarëve, institucionet qendrore të shtetit kanë ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për të proceduar dhe zhvilluar procesin e hartimit të buxhetit për të gjitha institucionet përfshirë edhe komunat duke iu shpërndarë qarkoret buxhetore si dokumente bazë dhe të cilat përmbajnë instruksionet e nevojshme për finalizimin e procesit si tërësi.

Procesi i hartimit të projektbuxhetit me të drejtë konsiderohet si njëri ndër proceset më të rëndësishme për një organizatë buxhetore, për faktin se nga ai proces hartohet buxheti si një ligj i cili përmban planin e financimit të funksioneve dhe detyrimeve të shtetit.

Organizata jonë buxhetore (656) ka zhvilluar procesin e hartimit të buxhetit për vitet 2027-2029, në harmoni me instruksionet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve përmes Qarkoreve Buxhetore 2027/01 dhe 2027/02, me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029 dhe me legjislacionin për menaxhimin e financave publike dhe financat lokale. Projektbuxheti përmban burimet e financimit, projeksionet e shpenzimeve dhe prioritetet e qeverisë lokale, të shpërndara në pesë kategori ekonomike dhe në programet buxhetore të Komunës.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka përcaktuar kufijtë buxhetorë duke u mbështetur në vendimet e Komisionit të Granteve dhe kriteret ligjore për ndarjen e granteve. Nga këto përcaktime dhe nga planifikimi i të hyrave vetanake rezulton se buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2027 është 56,102,329.00 €.

Struktura e financimit buxhetor

Struktura e financimit buxhetor të komunës përbëhet prej dy burimeve të financimit dhe atë:

1. **Granti qeveritar:**
   - Granti i përgjithshëm;
   - Granti specifik i arsimit;
   - Granti specifik i shëndetësisë;
   - Granti shtesë për Qendrës Rezidenciale;
   - Granti për Teatër dhe

2. **Të hyrat vetanake**

Struktura e financimit		
Përshkrimi	**Viti 2027**	**Pjesëmarrja në %**
Granti i përgjithshëm	**23,375,852.00**	**41.67%**
Granti specifik i Arsimit	**18,082,045.00**	**32.23%**
Granti specifik i Shëndetësis	**5,027,241.00**	**8.96%**
Financimi për QR	**580,000.00**	**1.03%**
Financimi për teatro	**331,328.00**	**0.59%**
Të hyrat vetanake	**8,705,863.00**	**15.52%**
Totali	**56,102,329.00**	**100.00%**

Tabela 1 Burimet e financimit

Përshkrimi	Buxheti i vitit 2026	Buxheti I vitit 2027	krahasimi në vlerë	Krahasimi në %
Buxheti	**53,068,494.00**	**56,102,329.00**	**3,033,835.00**	**5.72%**

Tabela 2. Krahasimi i buxhetit 2026/2027

Buxheti i vitit 2027 karakterizohet me rritje të vlerës së përgjithshme buxhetore. Krahasuar me vitin 2026, buxheti rritet nga 53,068,494.00 € në 56,102,329.00 €, ose për 3,033,835.00 € (5.72%). Rritja ndikohet veçanërisht nga Granti i përgjithshëm, i cili rritet për 9.52%, dhe nga Të Hyrat Vetanake, të cilat rriten për 13.65%, duke krijuar hapësirë shtesë për financimin e prioriteteve komunale.

Struktura buxhetore me burim financimi dhe krahasimi 2026/2027

Burimin e financimit të projektbuxhetit për vitin 2027 e karakterizon rritja e grantit qeveritar nga 45,408,225.00 € në vitin 2026 në 47,396,466.00 € në vitin 2027, ose për 4.38%. Të hyrat vetanake rriten nga 7,660,269.00 € në 8,705,863.00 €, ose për 13.65%. Në total, buxheti rritet nga 53,068,494.00 € në 56,102,329.00 €, që paraqet rritje prej 5.72% krahasuar me vitin 2026.

	Viti 2026	**Të dhënat nga qarkorja e parë**	**Krahasimi 2027-2026 në vlerë**	**Krahasimi 2027/2026 në %**
	Buxheti aktual	**2027/01**		
Granti i përgjithshëm	**21,344,474.00**	**23,375,852.00**	**2,031,378.00**	**9.52%**
Granti specifik i Arsimit	**18,177,776.00**	**18,082,045.00**	**-95,731.00**	**-0.53%**
Granti specifik i Shëndetësis	**4,992,290.00**	**5,027,241.00**	**34,951.00**	**0.70%**
Financimi për QR	**580,000.00**	**580,000.00**	**0.00**	**0.00%**
Financimi për teatro	**313,685.00**	**331,328.00**	**17,643.00**	**5.62%**
Të hyrat vetanake	**7,660,269.00**	**8,705,863.00**	**1,045,594.00**	**13.65%**
Totali	**53,068,494.00**	**56,102,329.00**	**3,033,835.00**	**5.72%**

Synimet e qeverisë lokale në kuadër të planifikimit buxhetor

Në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor, kërkesa totale e Komunës është mbajtur brenda kufirit të përgjithshëm të përcaktuar në Qarkoren Buxhetore 2027/02. Brenda këtij totali, kërkesa e organizatës buxhetore paraqet rishpërndarje ndërmjet kategorive ekonomike, duke ruajtur të pandryshuar vlerën e përgjithshme të projektbuxhetit.

Kufiri total i përcaktuar me Qarkoren Buxhetore dhe kërkesa totale e Komunës janë në vlerë prej 56,102,329.00 €. Në KAB, kërkesa e Komunës për kategorinë Paga dhe Shtesa është planifikuar 49,612.00 € më e ulët se kufiri i përcaktuar, ndërsa për Shpenzimet Kapitale është planifikuar 49,612.00 € më e lartë. Kjo rishpërndarje ndërmjet dy kategorive nuk e ndryshon vlerën e përgjithshme të buxhetit. Mallrat dhe Shërbimet, Shpenzimet Komunale dhe Subvencionet mbeten në nivelin e kufijve të përcaktuar.

Në strukturën e shpenzimeve për vitin 2027, Paga dhe Shtesa planifikohen 24,561,220.00 €, Mallra dhe Shërbime 12,183,659.00 €, Shpenzime Komunale 1,457,062.00 €, Subvencione dhe Transfere 2,550,000.00 €, ndërsa Investime Kapitale 15,350,388.00 €. Këto ndarje janë reflektuar në programet buxhetore dhe në projektet kapitale sipas prioriteteve të Komunës.

Kufijtë e përcaktuar me Qarkoren Buxhetore janë detyrues për njësitë buxhetore. Për këtë arsye, planifikimi 2027-2029 është bërë duke respektuar kufirin e përgjithshëm dhe duke orientuar burimet e disponueshme në shërbime publike efikase, arsim e inovacion, shëndetësi lokale, zhvillim ekonomik, infrastrukturë dhe mjedis, bujqësi e zhvillim rural, si dhe kulturë, rini dhe sport.

Buxheti mbetet i kufizuar krahasuar me tërësinë e nevojave zhvillimore të Komunës, prandaj mjetet e vitit fiskal 2027 duhet të shfrytëzohen me efikasitet të plotë, në përputhje me prioritetet e përcaktuara dhe me legjislacionin që rregullon shpenzimin e parasë publike. Bashkëfinancimi me ministritë, donatorët dhe partnerët tjerë mbetet instrument i rëndësishëm për zgjerimin e kapacitetit investiv.

Procesi buxhetor për periudhën 2027-2029 mbështetet në Kornizën Afatmesme Buxhetore, në Qarkoret Buxhetore dhe në legjislacionin për menaxhimin e financave publike dhe financat lokale. KAB-i shërben si bazë për përcaktimin e sektorëve prioritarë dhe për shpërndarjen e burimeve financiare.

Projektbuxheti përmban burimet e financimit, projeksionet e shpenzimeve dhe prioritetet e qeverisë lokale, të shpërndara në pesë kategori ekonomike dhe në programet buxhetore të Komunës.

Shpenzimet operative synojnë mbulimin e kompetencave komunale dhe funksionimin efikas të administratës publike, arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, ndërsa investimet kapitale orientohen sipas prioriteteve dhe projekteve të planifikuara.

Në kuadër të limiteve përcaktuese përfshihet edhe numri i të punësuarve. Kufiri sipas Qarkores për vitin 2027 është 2,495 pozita dhe kërkesa e organizatës buxhetore është po ashtu 2,495 pozita.

Kufijtë e financimit

Nr	Kategoria	Kufiri I përcaktuar me qarkoren buxhetore 2027/2	Kërkesa e organizates buxhetore	Ndryshimi
	Stafi	2495	2495	0
1	Pagat dhe shtesat	24,561,220.00	24,511,608.00	49,612.00
2	Mallëra dhe sherbime	12,183,659.00	12,183,659.00	0.00
3	Komunali	1,457,062.00	1,457,062.00	0.00
4	Subvencione	2,550,000.00	2,550,000.00	0.00
5	Shpenzime kapitale	15,350,388.00	15,400,000.00	-49,612.00
6	Totali I buxhetit	56,102,329.00	56,102,329.00	0.00

Burimet e financimit

Buxheti i vitit 2027 financohet nga dy burime kryesore: Granti qeveritar dhe Të Hyrat Vetanake.

GRANTI QEVERITAR - Granti qeveritar është burimi kryesor i financimit të buxhetit të Komunës. Për vitin 2027 planifikohet në vlerë 47,396,466.00 €, që përbën 84.48% të buxhetit të përgjithshëm. Grantet ndahen sipas kritereve dhe formulave ligjore të përcaktuara nga niveli qendror.

Grantet qeveritare ndahen sipas formulave dhe kritereve ligjore të përcaktuara nga niveli qendror. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2023, Komuna e Ferizajt ka 109,255 banorë.

Për vitin 2027, Granti i përgjithshëm planifikohet 23,375,852.00 €, Granti specifik i Arsimit 18,082,045.00 €, Granti specifik i Shëndetësisë 5,027,241.00 €, financimi për Qendrën Rezidenciale 580,000.00 € dhe financimi për Teatrin e qytetit 331,328.00 €. Këto burime, së bashku me të hyrat vetanake, përbëjnë bazën e financimit të programeve komunale.

TË HYRAT VETANAKE - Të hyrat vetanake për vitin 2027 planifikohen në vlerë 8,705,863.00 €, ose 15.52% të buxhetit të përgjithshëm. Krahasuar me vitin 2026, ato rriten për 1,045,594.00 €, apo 13.65%. Planifikimi bazohet në tatimin në pronë, taksat dhe ngarkesat komunale, të hyrat nga shërbimet administrative, arsimi, shëndetësia, qiratë dhe burimet tjera të lejuara me ligj.

Të hyrat nga Administrata Komunale: Të hyrat vetanake komunale realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores për Tarifat dhe Ngarkesat Komunale, Rregullores së Tatimit në Pronë dhe dispozitave tjera ligjore që përcaktojnë llojet e të hyrave që Komuna ka të drejtë t'i inkasojë.

Për vitin 2027, Tatimi në Pronë planifikohet në vlerë 3,602,276.00 €, ndërsa taksat komunale në vlerë 3,840,000.00 €. Këto zëra janë pjesë e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2027.

Të hyrat nga arsimi: Për vitin 2027, bashkë-pagesat për arsim planifikohen në vlerë 110,000.00 €. Kjo kategori është pjesë e të hyrave vetanake komunale të planifikuara për periudhën 2027-2029.

Të hyrat nga shëndetësia: Për vitin 2027, bashkë-pagesat për shëndetësi planifikohen në vlerë 190,000.00 €. Këto të hyra janë pjesë e të hyrave vetanake komunale të planifikuara për periudhën 2027-2029.

Burimi I financimit	**Viti 2027**	**Pjesëmarrja në përqindje**
Granti qeveritar	**47,396,466.00**	**84.48%**
Te hyrat vetanake	**8,705,863.00**	**15.52%**
Totali	**56,102,329.00**	**100.00%**

Tabela 4. Pjesëmarrja e burimeve të financimit

PËRCAKTIMI I PRIORITETEVE

Përcaktimi i prioriteteve për periudhën 2027-2029 mbështetet në Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe në Strategjinë Zhvillimore Komunale. Vizioni është ndërtimi i një Ferizaj modern, të digjitalizuar, të gjelbër, funksional dhe të bashkë-qeverisur me qytetarët. Prioritetet kryesore janë: 1) shërbimet publike dhe administrata, përmes platformës "Ferizaj Digjital", digjitalizimit të shërbimeve, arkivit kadastral, lejeve, transportit urban dhe infrastrukturës nëntokësore; 2) arsimi dhe inovacioni, përmes SmartBoard-eve, kabineteve të TI-së, laboratorëve, bibliotekave digjitale, çerdheve, shkollave dhe bursave për drejtimet deficitare; 3) shëndetësia lokale, përmes përfundimit të QKMF-së së re, QMF-ve të reja, qendrës së dytë emergjente, shërbimeve specialistike e laboratorike dhe barnatores 24-orëshe; 4) zhvillimi ekonomik dhe bizneset lokale, përmes zonave ekonomike, partneriteteve publiko-private, mbështetjes së sektorit privat, grave në biznes dhe përfshirjes së diasporës; 5) infrastruktura, zhvillimi urban dhe mjedisi, përmes planifikimit hapësinor, rrugëve, parkingjeve, gjelbërimit, ujit të pijes, trajtimit të ujërave të zeza dhe Parkut të Ri të Qytetit; 6) bujqësia dhe zhvillimi rural, përmes agrobiznesit, serrave smart, sistemeve alternative të ujitjes dhe rrugëve të arave; dhe 7) kultura, rinia dhe sporti, përmes stadiumeve, palestrave, ligave shkollore, eventeve rinore e sportive dhe festivaleve kulturore.

NDIKIMI I BUXHETIT KRAHAS PROBLEMEVE TË KOMUNËS

Nevojat për zhvillim të gjithëmbarshëm të Komunës mbeten më të mëdha se mundësitë buxhetore. Megjithatë, buxheti i vitit fiskal 2027 do të ndikojë drejtpërdrejt në përmirësimin e shërbimeve, infrastrukturës dhe cilësisë së jetës. Investimet në rrugë, ujësjellës e kanalizim, arsim, shëndetësi, mjedis, ekonomi lokale, bujqësi, kulturë dhe sport, të kombinuara me politikat subvencionuese dhe bashkëfinancimin me partnerë të jashtëm, synojnë të rrisin efektin zhvillimor të buxhetit dhe të gjenerojnë mundësi të reja ekonomike e sociale.

SHPËRNDARJA E BUXHETIT NË KATEGORI EKONOMIKE

Shpenzimet sipas kategorive ekonomike janë planifikuar në funksion të nevojave të programeve buxhetore. Kategoria Mallra dhe Shërbime përfshin shërbimet kontraktuese, furnizimet, mirëmbajtjen, derivatet, telekomunikimin dhe shpenzimet tjera operative të nevojshme për funksionimin e programeve. Struktura buxhetore përmban pesë kategori ekonomike përmes së cilave organizata buxhetore realizon projeksionet e saj institucionale në shërbim të qytetarëve.

Kategoritë ekonomike janë: Paga dhe Shtesa,Mallra dhe shërbime, Shpenzimet komunale,Subvencione dhe transfere dhe Investimet Kapitale.

Kategoria ekonomike	Buxheti i vitit 2027	Pjesmarrja në %
Pagat dhe shtesat	24,561,220.00	43.78%
Mallrat dhe Shërbimet	12,183,659.00	21.72%
Shpenzimet komunale	1,457,062.00	2.60%
Subvencionet	2,550,000.00	4.55%
Shpenzimet kapitale	15,350,388.00	27.36%
TOTALI	**56,102,329.00**	**100.00%**

Kategoria "Paga dhe Shtesa" për vitin 2027 planifikohet 24,561,220.00 €, që paraqet rritje prej 937,367.00 € ose 3.97% krahasuar me vitin 2026. Kjo kategori përbën rreth 43.78% të buxhetit të përgjithshëm. Planifikimi është bërë brenda kufirit buxhetor të përcaktuar për këtë kategori.

Kodi ekonomik	Kategorit ekonomike	Buxheti aktual 2026	Buxheti 2027	Ndryshimi	%
11100	Pagat dhe shtesat	23,623,853.00	24,561,220.00	937,367.00	3.97%

Kategoria "Mallra dhe Shërbime" për vitin 2027 planifikohet 12,183,659.00 €, ose rreth 21.72% të buxhetit të përgjithshëm. Krahasuar me vlerën 11,519,945.00 € të vitit 2026, kjo kategori rritet për 663,714.00 €, apo 5.76%. Planifikimi përfshin shërbimet kontraktuese, furnizimet, mirëmbajtjen, derivatet, telekomunikimin dhe shpenzimet tjera operative të nevojshme për funksionimin e programeve.

Kodi ekonomik	Kategorit Ekonomike	Buxheti aktual 2026	Buxheti 2027	Ndryshimi	%
13000	**Mallra dhe Shërbime**	**11,519,945**	**12,183,659**	**663,714**	**5.76%**
1310	**SHPENZIMET E UDHËTIMIT**	**38,018**	**76,187**	**38,169**	**100.40%**
13130	Transporti për udhëtime zyrtare brenda vendit	7,325	8,000	675	9.21%
13131	Para xhepi/mëditjet për udhëtime zyrtare brenda vendit	0	14,797	14,797	-
13132	Akomodimi për udhëtimet zyrtare brenda vendit	5,759	9,390	3,631	63.04%
13140	Transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendit	9,913	11,000	1,087	10.96%
13141	Para xhepi/mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit	2,304	3,000	696	30.22%
13142	Akomodimi për udhëtimet zyrtare jashtë vendit	3,456	29,000	25,544	739.22%
13143	Shpenzimet e tjera për udhëtimet zyrtare jashtë vendit	9,261	1,000	-8,261	-89.20%
1330	**SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT**	**86,390**	**55,000**	**-31,390**	**-36.34%**
13310	Interneti	11,519	18,000	6,481	56.27%
13320	Telefonia mobile	34,556	33,000	-1,556	-4.50%
13330	Shërbimet postare	40,315	4,000	-36,315	-90.08%
1340	**SHPENZIMET PËR SHËRBIME**	**3,860,248**	**4,953,880**	**1,093,632**	**28.33%**
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	29,685	41,000	11,315	38.12%
13430	Shërbimet e ndryshme shëndetësore	3,456	11,000	7,544	218.32%
13440	Shërbimet këshilldhënëse dhe profesionale	230,373	108,186	-122,187	-53.04%
13445	Shërbimet e veçanta - konsulentë dhe kontraktorë individual	230,373	366,860	136,487	59.25%
13450	Shërbimet e shtypjes/printimit	126,561	96,000	-30,561	-24.15%
13460	Shërbimet kontraktuese të tjera	2,473,810	3,639,834	1,166,024	47.13%
13470	Shërbimet teknike	5,759	2,000	-3,759	-65.27%
13475	Sigurimi fizik i objekteve publike	691,119	624,000	-67,119	-9.71%
13480	Shpenzimet e anëtarësimit	69,112	65,000	-4,112	-5.95%
1350	**BLERJA E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE (MË PAK SE 1000 EURO)**	**286,395**	**247,704**	**-38,691**	**-13.51%**
13501	Mobiljet	17,278	22,000	4,722	27.33%
13503	Kompjuterët	53,837	48,000	-5,837	-10.84%
13505	Makinat fotokopjuese-multifunksionale	25,222	0	-25,222	-100.00%
13506	Pajisjet specialistike mjekësore	17,278	20,000	2,722	15.75%
13509	Pajisjet e tjera	172,780	152,704	-20,076	-11.62%

13510	Blerja e librave dhe veprave artistike	0	5,000	5,000	-
1360	**BLERJE TJERA - MALLRA DHE SHERBIME**	**1,100,031**	**1,016,649**	**-83,382**	**-7.58%**
13610	Furnizimet për zyrë	287,966	261,000	-26,966	-9.36%
13611	Furnizimi me dokumente bllanko	0	20,000	20,000	-
13616	Furnizimi me artikuj bujqësor	287,966	302,538	14,572	5.06%
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	230,373	83,000	-147,373	-63.97%
13630	Furnizime mjekësore	230,373	261,111	30,738	13.34%
13640	Furnizimet e pastrimit	57,593	89,000	31,407	54.53%
13650	Furnizim me veshmbathje	5,759	0	-5,759	-100.00%
13700	**DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE**	**1,055,111**	**1,207,000**	**151,889**	**14.40%**
13720	Nafta për ngrohje qendrore	340,651	426,000	85,349	25.05%
13760	Drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje	575,933	651,000	75,067	13.03%
13780	Derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri	138,527	130,000	-8,527	-6.16%
1380	**LLOGARITË E AVANCEVE (PARADHËNIES)**	**27,359**	**29,000**	**1,641**	**6.00%**
13810	Avancë (paradhënia) për para të imëta	5,759	7,000	1,241	21.54%
13820	Avancë (paradhënia) për udhëtime zyrtare	21,600	22,000	400	1.85%
1395	**SHËRBIMET E REGJISTRIMIT DHE TË SIGURIMEVE**	**31,403**	**35,000**	**3,597**	**11.45%**
13950	Regjistrimi i automjeteve	19,884	22,000	2,116	10.64%
13951	Sigurimi i automjeteve	11,519	13,000	1,481	12.86%
1400	**MIRËMBAJTJA**	**4,937,081**	**4,505,239**	**-431,842**	**-8.75%**
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	69,112	79,000	9,888	14.31%
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative dhe afariste	287,966	740,000	452,034	156.97%
14023	Mirëmbajtja e ndërtesave arsimore	1,267,052	1,113,000	-154,052	-12.16%
14024	Mirëmbajtja e ndërtesave shëndetësore	172,780	240,000	67,220	38.91%
14026	Mirëmbajtja e objekteve sportive	57,593	89,000	31,407	54.53%
14027	Mirëmbajtja e objekteve kulturore	0	22,953	22,953	-
14030	Mirëmbajtja e autorrugëve	138,224	122,000	-16,224	-11.74%
14032	Mirëmbajtja e rrugëve lokale	1,381,804	1,323,286	-58,518	-4.23%
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit	60,238	73,000	12,762	21.19%
14050	Mirëmbajtja e mobiljeve dhe pajisjeve	4,888	10,000	5,112	104.58%
14060	Mirëmbajtja rutinore	1,497,425	693,000	-804,425	-53.72%
1410	**QIRAJA**	**51,834**	**40,000**	**-11,834**	**-22.83%**
14110	Qiraja për ndërtesa	34,556	40,000	5,444	15.75%
14140	Qiraja për makineri	17,278	0	-17,278	-100.00%
1430	**SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT**	**46,075**	**18,000**	**-28,075**	**-60.93%**
14310	Kompensimi i përfaqësimit brenda vendit	46,075	18,000	-28,075	-60.93%

Kategoria "Shpenzimet Komunale" për vitin 2027 planifikohet 1,457,062.00 €, ose rreth 2.60% të buxhetit të përgjithshëm. Krahasuar me 1,010,982.00 € në vitin 2026, rritja është 446,080.00 €, apo 44.12%, e ndikuar kryesisht nga nevojat për energji elektrike, ujë, mbeturina dhe telefoni fikse.

Kodi ekonomik	Kategoria ekonomike	Buxheti aktual 2026	Buxheti 2027	ndryshimi	%
13200	**SHPENZIMET KOMUNALE**	**1,010,982.00**	**1,457,062.00**	**446,080.00**	**44.12%**
1320	**SHPENZIMET KOMUNALE**	1,010,982.00	1,457,062.00	**446,080.00**	44.12%
13210	Energjia elektrike	950,000.00	1,396,062.00	**446,062.00**	46.95%
13220	Shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	35,000.00	31,000.00	**-4,000.00**	-11.43%
13230	Mbeturinat	19,982.00	21,000.00	**1,018.00**	5.09%
13250	Telefonia fikse	6,000.00	9,000.00	**3,000.00**	50.00%

Kategoria "Subvencionet dhe Transferet" për vitin 2027 planifikohet 2,550,000.00 €, që përbën rreth 4.55% të buxhetit. Krahasuar me vitin 2026, rritja është 50,000.00 €, ose 2.00%. Mjetet do të orientohen në përkrahje sociale, subvencione për entitete publike dhe jopublike, fermerë, aktivitete kulturore, rinore e sportive dhe forma tjera të mbështetjes sipas programeve komunale.

Kodi ekonomik	Kategorit ekonomike	Buxheti aktual 2026	Buxheti 2027	Ndryshimi	%
200	**SUBVENCIONET DHE TRANSFERET**	**2,500,000.00**	**2,550,000.00**	**50,000.00**	**2.00%**
2100	**SUBVENCIONET**	**530,000.00**	**693,511.00**	**163,511.00**	**30.85%**
21110	Subvencionet për entitetet publike	230,000.00	397,484.00	167,484.00	72.82%
21200	Subvencionet për entitetet jopublike	300,000.00	296,027.00	-3,973.00	-1.32%
2200	**TRANSFERET**	**1,660,000.00**	**1,612,267.00**	**-47,733.00**	**-2.88%**
22202	Transferet për përfitues individual tjerë	1,330,000.00	1,312,711.00	-17,289.00	-1.30%
22298	Pagesat për shërbimet e varrimit	330,000.00	299,556.00	-30,444.00	-9.23%
2310	**SUBVENCIONET PËR FERMERË**	**310,000.00**	**244,222.00**	**-65,778.00**	**-21.22%**
23110	Pagesat për sektorin e blegtorisë	185,000.00	146,222.00	-38,778.00	-20.96%
23130	Pagesat për kulturat bujqësore	125,000.00	98,000.00	-27,000.00	-21.60%

Kategoria "Investimet Kapitale" për vitin 2027 planifikohet në vlerë 15,350,388.00 €, ose rreth 27.36% të buxhetit të përgjithshëm. Krahasuar me 14,413,714.00 € në vitin 2026, investimet rriten për 936,674.00 €, apo 6.50%. Projektet përfshijnë infrastrukturë rrugore, ujësjellës e kanalizim, objekte arsimore e shëndetësore, parqe dhe hapësira publike, objekte sportive, pajisje dhe projekte të tjera prioritare të planifikuara për periudhën 2027-2029.

Kodi ekonomik	Kategorit Ekonomike	Buxheti aktual 2026	Buxheti 2027	Ndryshimi	%
30000	**Investimet Kapitale**	14,413,714	15,350,388	936,674	6.50%
3110	**NDËRTESAT**	2,030,000	2,460,000	430,000	**21.18%**
31110	Ndërtesat e banimit	0	340,000	340,000	-
31120	Ndërtesat administrative dhe afariste	350,000	60,000	-290,000	-82.86%
31121	Ndërtesat arsimore	1,100,000	1,720,000	620,000	56.36%
31122	Ndërtesat shëndetësore	580,000	340,000	-240,000	-41.38%
3111	**OBJEKTET**	583,714	440,000	-143,714	**-24.62%**
31123	Objektet kulturore	110,000	110,000	0	0.00%
31124	Objektet sportive	473,714	130,000	-343,714	-72.56%
31127	Depot	0	200,000	200,000	-
3112	**STRUKTURAT TJERA**	10,275,000	9,935,388	-339,612	**-3.31%**
31125	Monumentet dhe Komplekset Memoriale	0	230,000	230,000	-
31129	Fushat sportive	295,000	300,000	5,000	1.69%
31230	Rrugët lokale	5,400,000	6,705,388	1,305,388	24.17%
31240	Trotuaret	600,000	260,000	-340,000	-56.67%
31250	Rrjetet e kanalizimit	1,400,000	1,180,000	-220,000	-15.71%
31260	Rrjetet e ujësjellësit	2,200,000	980,000	-1,220,000	-55.45%
31930	Deponitë e mbeturinave	130,000	0	-130,000	-100.00%
32111	Sistemet e ujitjes	0	280,000	280,000	-
33202	Shtretërit e lumenjëve	250,000	0	-250,000	-100.00%
3150	**PAJISJET**	0	50,000	50,000	-
31510	Pajisjet e gjenerimit të energjisë elektrike dhe ndriçimit publik	0	50,000	50,000	-
3160	**PAJISJET**	300,000	0	-300,000	**-100.00%**
31660	Pajisjet mjekësore	150,000	0	-150,000	-100.00%
31690	Pajisje Tjera	150,000	0	-150,000	-100.00%
3170	**MJETET TRANSPORTUESE DHE MAKINERIA**	75,000	30,000	-45,000	**-60.00%**
31700	Veturat zyrtare	0	30,000	30,000	-
31703	Veturat e ndihmës së shpejtë	75,000	0	-75,000	-100.00%
3210	**TOKAT, PARQET, PYJET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE**	1,150,000	2,435,000	1,285,000	**111.74%**
32140	Parqet dhe hapësirat publike	1,150,000	2,435,000	1,285,000	111.74%

SHPËRNDARJA E BUXHETIT NË PROGRAME BUXHETORE

Në këtë kapitull të projektbuxhetit për vitin 2027 paraqitet shpërndarja buxhetore sipas kategorive ekonomike për secilin program buxhetor. Ndarjet janë bërë duke marrë për bazë kufijtë e Qarkores, Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029 dhe prioritetet e Komunës, me ndarje sipas burimit të financimit: Grantet Qeveritare dhe Të Hyrat Vetanake.

Pjesë e buxhetit 2027-2029 janë tabelat që paraqesin të hyrat dhe shpenzimet komunale, planin afatmesëm të të hyrave, ndarjet buxhetore, investimet kapitale dhe financimin e projekteve sipas burimeve të financimit.

Tabelat buxhetore:
Tabela I- Të hyrave dhe shpenzimeve komunale;
Tabela II- Plani Afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal;
Tabela III- Plani i ndarjeve buxhetore;
Tabela IV- Plani Afatmesëm 2027-2029 për Investime Kapitale;
Tabela V - Financimi i projekteve sipas burimeve të financimit

Tabela I- Të hyrat dhe shpenzimet komunale

Nr.	Përshkrimi	Viti 2026 Buxheti aktual	Planifikimi për Vitin 2027	Viti 2028 Vlerësimi	Viti 2029 Vlerësimi	Krahasimi 2027/2026 ne %
1	**TË HYRAT KOMUNALE TOTALE**	**53,068,494.00**	**56,102,329.00**	**58,907,504.00**	**62,114,784.00**	**5.72%**
1.1	**Grantet qeveritare**	45,408,225.00	47,396,466.00	49,915,434.00	52,658,243.00	4.38%
1.3	**Të hyrat vetanake**	7,660,269.00	8,705,863.00	8,992,070.00	9,456,541.00	13.65%
		53,068,494.00	**56,102,329.00**	**58,907,504.00**	**62,114,784.00**	**5.72%**
2.1	**Shpenzimet rrjedhëse**	**38,654,780.00**	**40,751,941.00**	**43,325,253.00**	**44,719,774.00**	**5.43%**
2.1.1	**Pagat dhe shtesat**	23,623,853.00	24,561,220.00	24,684,027.00	24,807,447.00	3.97%
2.1.2	**Mallrat dhe Shërbimet**	11,519,945.00	12,183,659.00	14,391,226.00	15,447,577.00	5.76%
2.1.3	**Shpenzimet komunale**	1,010,982.00	1,457,062.00	1,530,000.00	1,644,750.00	44.12%
2.1.4	**Subvencionet**	2,500,000.00	2,550,000.00	2,720,000.00	2,820,000.00	2.00%
2.2	**Shpenzimet kapitale**	**14,413,714.00**	**15,350,388.00**	**15,582,251.00**	**17,395,010.00**	**6.50%**

TABELA II Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2027-2029

	Përshkrimi	Viti 2026	Viti 2027 Plan	Viti 2028 vlerësimi	Viti 2029 vlerësimi
1.1	**TË HYRAT KOMUNALE-TOTALE**	**53,068,494.00**	**56,102,329.00**	**58,907,504.00**	**62,114,784.00**
1.2	**GRANTI QEVERITAR**	**45,408,225.00**	**47,396,466.00**	**49,915,434.00**	**52,658,243.00**
1.1.4	**TË HYRAT VETANAKE**	**7,660,269.00**	**8,705,863.00**	**8,992,070.00**	**9,456,541.00**
1.1.1	Tatimi në pronë	3,274,540.00	3,602,276.00	3,634,325.00	3,652,496.00
	Taksat komunale	**3,290,000.00**	**3,840,000.00**	**4,030,000.00**	**4,370,000.00**
	Certifikatat dhe dokumentet zyrtare	100,000.00	120,000.00	125,000.00	135,000.00
	Taksat e pajisjeve motorike	380,000.00	440,000.00	460,000.00	500,000.00
	Lejet për ndërtesa	2,100,000.00	2,450,000.00	2,570,000.00	2,790,000.00
	Matjet gjeodezike	250,000.00	300,000.00	315,000.00	345,000.00
	Taksat tjera komunale	130,000.00	150,000.00	160,000.00	170,000.00
	Taksat per legalizimin e prones	330,000.00	380,000.00	400,000.00	430,000.00
1.1.3	**Ngarkesat komunale**	**995,729.00**	**1,150,000.00**	**1,205,000.00**	**1,305,000.00**
	Të hyrat nga qiraja	130,000.00	150,000.00	158,000.00	170,000.00
	Bashkë-pagesat për arsim	100,000.00	110,000.00	112,000.00	125,000.00
	Bashkë-pagesat për shëndetësi	165,729.00	190,000.00	200,000.00	215,000.00
1.1.4	Ngarkesat tjera komunale përfshir (gjobat)	600,000.00	700,000.00	735,000.00	795,000.00
1.2	**Të hyrat tjera**	**100,000.00**	**113,587.00**	**122,745.00**	**129,045.00**
1.2.1	**TRANSFERET QEVERITARE**	**45,408,225.00**	**47,396,466.00**	**49,915,434.00**	**52,658,243.00**
1.2.2	Granti i përgjithshëm	21,344,474.00	23,375,852.00	25,148,318.00	27,137,825.00
1.2.3	Granti specifik për arsim	18,177,776.00	18,082,045.00	18,624,507.00	19,183,242.00
1.2.4	Granti specifik për Shëndetsi	4,992,290.00	5,027,241.00	5,178,058.00	5,333,400.00
1.2.6	Granti për qendren razidenciale	580,000.00	580,000.00	615,000.00	635,000.00
1.2.7	Granti për teatro	313,685.00	331,328.00	349,551.00	368,776.00

Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2027

Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total
d	e	f	g	h	i	j	k
SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	**2495**	**24,561,220.00**	**12,183,659.00**	**1,457,062.00**	**2,550,000.00**	**15,350,388.00**	**56,102,329.0**
Grantet Qeveritare	2495	24,561,220.00	8,741,179.00	1,457,062.00	69,486.00	12,567,519.00	47,396,466.0
Të hyrat vetanake		-	3,442,480.00	-	2,480,514.00	2,782,869.00	8,705,863.0
Zyra e Kryetarit	**29**	**371,039.86**	**170,000.00**	**-**	**150,000.00**	**-**	**691,039.8**
Grantet Qeveritare	29	371,039.86	43,000.00	-	-	-	414,039.8
Të hyrat vetanake		-	127,000.00	-	150,000.00	-	277,000.0
Zyra e Kuvendit Komunal	**41**	**446,535.79**	**22,000.00**	**-**	**-**	**-**	**468,535.7**
Grantet Qeveritare	41	446,535.79	22,000.00	-	-	-	468,535.7
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Administrata dhe personeli	**45**	**414,596.78**	**3,200,713.00**	**1,126,562.00**	**-**	**80,000.00**	**4,821,871.7**
Grantet Qeveritare	45	414,596.78	2,310,713.00	1,126,562.00	-	29,731.00	3,881,602.7
Të hyrat vetanake		-	890,000.00	-	-	50,269.00	940,269.0
Administrata	**19**	**164,583.48**	**3,090,000.00**	**1,126,562.00**	**-**	**80,000.00**	**4,461,145.4**
Grantet Qeveritare	19	164,583.48	2,200,000.00	1,126,562.00	-	29,731.00	3,520,876.4
Të hyrat vetanake		-	890,000.00	-	-	50,269.00	940,269.0
Çështjet ligjore	**6**	**60,793.75**	**-**	**-**	**-**	**-**	**60,793.7**
Grantet Qeveritare	6	60,793.75	-	-	-	-	60,793.7
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Regjistrimi civil	**14**	**130,762.46**	**110,713.00**	**-**	**-**	**-**	**241,475.4**
Grantet Qeveritare	**14**	130,762.46	110,713.00	-	-	-	**241,475.4**
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Komunikimi	**6**	**58,457.09**	**-**	**-**	**-**	**-**	**58,457.0**
Grantet Qeveritare	6	58,457.09	-	-	-	-	**58,457.0**
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Prokurimi	**5**	**50,614.88**	**-**	**-**	**-**	**-**	**50,614.8**
Grantet Qeveritare	5	50,614.88	-	-	-	-	**50,614.8**
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Buxheti dhe financat	**36**	**338,988.36**	**465,659.00**	**-**	**-**	**-**	**804,647.3**
Grantet Qeveritare	36	338,988.36	165,659.00	-	-	-	**504,647.3**
Të hyrat vetanake		-	300,000.00	-	-	-	**300,000.0**
Buxhetimi	**24**	**227,083.45**	**300,000.00**	**-**	**-**	**-**	**527,083.4**
Grantet Qeveritare	24	227,083.45	-	-	-	-	**227,083.4**
Të hyrat vetanake		-	300,000.00	-	-	-	**300,000.0**

Administrimi dhe mbledhja e tatimit në pronë	**12**	**111,904.91**	**165,659.00**	-	-	-	**277,563.9**
Grantet Qeveritare	12	111,904.91	165,659.00	-	-	-	**277,563.9**
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca	**45**	**493,321.02**	**2,459,472.00**	**20,000.00**	**400,000.00**	**9,700,388.00**	**13,073,181.0**
Grantet Qeveritare	45	493,321.02	1,598,136.00	20,000.00	-	8,487,788.00	**10,599,245.0**
Të hyrat vetanake		-	861,336.00	-	400,000.00	1,212,600.00	**2,473,936.0**
Infrastruktura rrugore	**9**	**101,944.74**	**2,074,286.00**	-	**400,000.00**	**1,390,000.00**	**3,966,230.7**
Grantet Qeveritare	9	101,944.74	1,284,950.00	-	-	1,140,000.00	**2,526,894.7**
Të hyrat vetanake		-	789,336.00	-	400,000.00	250,000.00	**1,439,336.0**
Infrastruktura publike	**6**	**67,816.78**	**200,000.00**	-	-	**8,310,388.00**	**8,578,204.7**
Grantet Qeveritare	6	67,816.78	128,000.00	-	-	7,347,788.00	**7,543,604.7**
Të hyrat vetanake		-	72,000.00	-	-	962,600.00	**1,034,600.0**
Zjarrëfikësit dhe inspektimet	**30**	**323,559.49**	**185,186.00**	**20,000.00**	-	-	**528,745.4**
Grantet Qeveritare	30	323,559.49	185,186.00	20,000.00	-	-	**528,745.4**
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Zyra e komuniteteve	**13**	**114,619.62**	**11,000.00**	-	-	-	**125,619.6**
Grantet Qeveritare	13	114,619.62	11,000.00	-	-	-	**125,619.6**
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural	**5**	**45,055.75**	**450,000.00**	-	**350,000.00**	**960,000.00**	**1,805,055.7**
Grantet Qeveritare	5	45,055.75	168,538.00	-	-	700,000.00	913,593.7
Të hyrat vetanake		-	281,462.00	-	350,000.00	260,000.00	891,462.0
Bujqësia	**5**	**45,055.75**	**450,000.00**	-	**350,000.00**	**960,000.00**	**1,805,055.7**
Grantet Qeveritare	5	45,055.75	168,538.00	-	-	700,000.00	**913,593.7**
Të hyrat vetanake		-	281,462.00	-	350,000.00	260,000.00	**891,462.0**
Zhvillimi ekonomik	**9**	**91,106.27**	**400,000.00**	-	**200,000.00**	**290,000.00**	**981,106.2**
Grantet Qeveritare	9	91,106.27	256,000.00	-	-	100,000.00	**447,106.2**
Të hyrat vetanake		-	144,000.00	-	200,000.00	190,000.00	**534,000.0**
Turizmi	**9**	**91,106.27**	**400,000.00**	-	**200,000.00**	**290,000.00**	**981,106.2**
Grantet Qeveritare	9	91,106.27	256,000.00	-	-	100,000.00	**447,106.2**
Të hyrat vetanake		-	144,000.00	-	200,000.00	190,000.00	**534,000.0**
Kadastra dhe gjeodezia	**18**	**172,360.10**	**100,000.00**	-	-	-	**272,360.1**
Grantet Qeveritare	18	172,360.10	100,000.00	-	-	-	**272,360.1**
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Shërbimet kadastrale	**12**	**114,866.44**	**45,456.00**	-	-	-	**160,322.4**
Grantet Qeveritare	12	114,866.44	45,456.00	-	-	-	**160,322.4**

Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Shërbimet e gjeodezisë	**6**	**57,493.66**	**54,544.00**	**-**	**-**	**-**	**112,037.6**
Grantet Qeveritare	6	57,493.66	54,544.00	-	-	-	**112,037.6**
Të hyrat vetanake		-	-	-	-	-	
Planifikimi urban dhe mjedisi	**12**	**128,928.08**	**400,000.00**	**-**	**-**	**1,330,000.00**	**1,858,928.0**
Grantet Qeveritare	12	128,928.08	196,429.00	-	-	800,000.00	**1,125,357.0**
Të hyrat vetanake		-	203,571.00	-	-	530,000.00	**733,571.0**
